



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.155/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rrustem Thaçi dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, me seli në Komunën e Pejës, paraqitur kundër subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Komunën e Gjakovës, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – vendosjes së posterave njoftues me slogane të subjektit politik, për fushatën zgjedhore në trafostacion dhe shtyllë elektrike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 04.10.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet e bazuar** ankesa e Iniciativës së Re Demokratike e Kosovës, me seli në Komunën e Pejës, subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane, me seli në Komunën Gjakovës, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike – vendosjes së posterave njoftues me slogane të subjektit politik, për fushatën zgjedhore në trafostacion dhe shtyllë elektrike – hapësira publike, i shqiptohet gjobë, në shumë prej 1,100.00 (njëmijë e qind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë), ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 01.10.2019, nga Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, me të cilën pretendon se në vende apo hapësira publike, ka vërejtur një parregullsi të cilën e kanë evidentuar me dy fotografi pasi që janë vendosur poster në vende që nuk janë të dedikuara për vendosjen e postrëve. Paraqitësi i ankesës potencon se me datën 30.09.2019, në rrugën “Ali Pashë Tepelena”, në Rrugën “Xhevded Bistrica”, dhe në rrugën Dedë Gjo Luli, të tri rrugët që gjenden në Gjakovë. Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se nga Partia Liberale Egjiptiane (PLE), është bërë shkelje e Ligjit për Zgjedhje. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, me propozim që ankesa të pranohet.

Në përgjigjen në ankesë, subjekti politik, Partia Liberale Egjiptiane (PLE), të datës 02.10.2019, kanë theksuar se tek fotografia e parë ku shihen tre persona duke e vendosur një poster në shtyllë elektrike nuk e kanë dijeni se kush janë ata person dhe po ashtu nuk kanë, ndërsa tek fotografia e dytë që ku shihet vendosja e një posterit në shtyllë elektrike, thekson se nga dega në Gjakovë dhe nga anëtarët e asaj dege kanë informata të sakta se nuk është vendosur as një poster nga ana jon, ndërsa në rastin-foto ku shihen posteret e vendosur në trafostacion elektrik, nuk janë vendosur nga anëtarët e degës në Gjakovë e as nga simpatizantët e tanë, por mundë të jenë vendosur nga rivalet politik. PLE, pas pranimi të njoftimit nga PZAP, menjëherë ka ndërmarr masat për ti larguar posteret në fjalë me propozim për panelin që të refuzohet ankesa.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe shkresat tjera të lëndës vlerësoi se:

## **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterët e kandidatëve për deputet nga PLE, janë vendosur në shtyllat elektrike dhe në trafostacion, të cilat vende nuk janë të dedikuara për vendosjen e posterave pai që janë hapësira apo vende publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, në të cilën përcaktohet se: *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve”*

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:


- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik PLE, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se ka qenë e njoftuar me rregullat zgjedhore dhe kodin e mirësjelljes për subjektet politike, edhe për kundër këtij fakti se posteret e kandidatëve nga ky subjekt politik të cilët janë vendosur në shtyllat elektrike dhe në trafostacion elektrik - vende apo hapësira publike. PZAP-i, ia dha mundësin për tu përgjigjur në ankesë subjektit politik PLE, ashtu që nga dy fotografitë e prezantuar nëpërmes përgjigjen në ankesë nga subjekti politik PLE, paneli konstatoi se subjekti në fjalë ka ndërmarr masa përmirësuese duke i larguar posteret nga vendet ku ishin të vendosur, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika a) të LZP-së, të cilat masa përmirësuese kanë ndikuar në shqiptimin e gjobës, si në dispozitiv të këtij vendimi, sepse gjoba për këtë natyrë të shkeljes nga subjekti politike do të mund të shqiptohet sipas nenit 3 paragrafi 2 i Rregullës Nr.01/2012, të PZAP-it, në lartësi prej 5,100.00 euro e deri në 20,000.00 euro.

Nga arsyet e lartcekura më lart e në kuptim të nenit 117 paragrafi dhe nenit 118 paragrafi 1 i LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr. 155/2019 më datën 04.10.2019

**Kryesues i Panelit**  
**Fejzullah Rexhepi**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.